



RAPORTI VJETOR 2013

JANAR 2014

Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë



APAAL

Tel 04 2 266302
Fax 04 2 266302

*Rruga e Durrësit, Pranë Gjmnazit
Qemal Stafa, Tiranë*

*www.aaal.edu.al, www.albranking.com,
E-Mail: info@aaal.edu.al,
infoaaal@gmail.com*

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| APAAL | 1 |
| 1. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë | 2 |
| 2. Këshilli i Akreditimit | 5 |
| 3. Organizimi i APAAL | 7 |
| 4. Ekspertët e vlerësimit të jashtëm | 9 |
| 5. Licensimi i institucioneve dhe programeve | 11 |
| 6. Akreditimi i institucioneve dhe programeve | 15 |
| 7. Analiza në arsimin e lartë dhe sistemi i menaxhimit të të dhënave | 22 |
| 8. Aktiviteti i Këshillit të Akreditimit dhe ekspertëve të jashtëm | 26 |
| 9. Aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare në arsimin e lartë | 31 |
| 10. Aktiviteti financiar gjatë vitit 2013 | 35 |
| 11. Sistemi i arkivimit, informimit dhe publikimit të informacionit | 38 |
| 12. Vetëvlerësimi i Performancës së APAAL për vitin 2013 | 41 |
| 13. Plani i aktiviteteve të APAAL – KA për vitin 2014 | 1 |
| 14. Aneksi i Raportit | 1 |
| Informacion për Kontakt | 13 |
| Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë | 13 |



Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, (APAAL) si institucion publik, pjesë e sistemit të sigurimit të jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë, në zbatim të detyrimit ligjor për informimin e publikut si dhe për kryerjen e analizës së ecurisë së saj gjatë vitit 2013, harton raportin e përvitshëm në të cilin paraqet në mënyrë të përmbledhur veprimtaritë kryesore.

Ky aktivitet intensiv ka qënë i fokusuar në shumë drejtime si për vlerësimin e programeve të reja të studimit, vlerësime në kuadrin e akreditimit, veprimtari të tjera njohëse dhe sensibilizuese me aktorë të arsimit të lartë dhe mjaft aktivitete të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

Informacione dhe të dhëna më të detajuara janë të publikuara në faqen zyrtare të APAAL.

APAAL

APAAL

Fokusi kryesor

APAAL ka si mision kryesor të saj, promovimin dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Mbështetur në besimin kryesor se “përgjegjësitë kryesore për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë janë vetë Institucionet e Arsimit të Lartë”, Agjencia, për kryerjen në mënyrë cilësore të misionit të saj, mbështetet në disa parime themelore si respektimin e autonomisë institucionale dhe lirisë akademike të Institucioneve të Arsimit të Lartë, transparencën dhe informimin në çdo hap të procesit, mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë në IAL, objektivizmin dhe profesionalizmin në të gjitha proceset e kryera prej saj si dhe në respektimin vetëm të kriterëve dhe standardeve shtetërore të cilësisë, të standardeve evropiane të cilësisë dhe në standartet akademike në AL.

Aktivitete në vitin 2013

Aktivitete kryesore të zhvilluara gjatë vitit 2013 kanë qënë të fokusuar kryesisht në proceset e vlerësimit në kuadër të licensimit dhe akreditimit, bashkëpunimi me insitucionet e arsimit të lartë, trajnime e pjesmarrje në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare etj.

Këshilli i Akreditimit

Këshilli i Akreditimit është organ kolegjal, që kryen veprimtarinë e vetë, pranë Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe organizohet sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Drejtori: Prof.Dr Avni Meshi
Janar 25, 2014

1. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë

Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), është një institucion shtetëror dhe publik, pjesë e Sistemit të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në Shqipëri, në varësi administrative të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, e krijuar me vendim të KM nr. 303, datë 01.07.1999, “Për krijimin e sistemit të akreditimit në arsimin e lartë”. APAAL ka si mision kryesor të saj, promovimin dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Mbështetur në besimin kryesor se “përgjegjësitë kryesore për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë janë vetë Institucionet e Arsimit të Lartë”, Agjencia, për kryerjen në mënyrë cilësore të misionit të saj, mbështetet në disa parime themelore si respektimin e autonomisë institucionale dhe lirisë akademike të Institucioneve të Arsimit të Lartë, transparencën dhe informimin në çdo hap të procesit, mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë në IAL, objektivizmin dhe profesionalizmin në të gjitha proceset e kryera prej saj si dhe në respektimin vetëm të kriterëve dhe standardeve shtetërore të cilësisë, të standardeve evropiane të cilësisë dhe në standardet. Disa nga funksionet kryesore të APAAL në fushën e arsimit të lartë janë:

- *APAAL*
- *Misioni*
- *Objektivat*
- *Funksionet kryesore*

- Promovimi dhe vlerësimi i jashtëm i cilësisë në Arsimin e lartë publik dhe privat, kryerja me autonomi të plotë e procedurave të vlerësimit, zgjedhja e metodave dhe instrumenteve të vlerësimit, ngritja e grupeve të ekspertëve të vlerësimit, si dhe formulimi i raporteve dhe rezultateve të vlerësimit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- APAAL është institucioni që regjistron kërkesat e IAL-ve për vlerësim dhe akreditim. Përgatit kalendarin vjetor të vlerësimeve dhe ja paraqet atë për miratim Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Ky kalendar bëhet publik për të gjitha IAL-të publike dhe private. Gjithashtu, agjencia organizon vlerësimin e treguesëve teknikë dhe në përmbajtje të sistemit të arsimit të lartë.
- APAAL zhvillon veprimtari të vlerësimit të jashtëm të cilësisë, me qëllim akreditimin e programit/ve të studimit apo të institucionit (publik dhe privat) dhe bën publike raportet dhe rezultatet e vlerësimeve të kryera. Përcakton kriteret dhe procedurat për

përzgjedhjen e ekspertëve të vlerësimit, apo konsulentëve, vendas dhe të huaj, të cilat i bën publike, pasi merr pëlqimin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Përzgjedhja e tyre bëhet përmes një konkurimi publik. Lista e ekspertëve pasurohet çdo vit.

- APAAL është përgjegjëse për realizimin e proceseve të renditjes/ranking dhe rating të programeve, fushave dhe institucioneve të arsimit të lartë. APAAL në bashkëpunim me KA, kryen dhe shpall renditjen (ranking) e IAL-ve ose diplomave të ngjashme në përputhje me këto rezultate. Shpeshtësia e kryerjes së ranking-ut dhe kriteret e tij miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Sportit.
- Agjencia është përgjegjëse për realizimin e indikatorëve dhe treguesëve për matjen e cilësisë. Në këtë drejtim, APAAL bashkëpunon me grupe ekspertësh dhe me institucione të arsimit të lartë.
- Në shërbim të politikave të arsimit të lartë, agjencia kryen vlerësime analitike dhe/ose krahasuese të institucioneve dhe të programeve të fushave të arsimit të lartë, sipas treguesve të caktuar dhe në raport me standardet ekzistuese, vendase apo ndërkombëtare.
- Mbështetur në kriteret e qarta, mbi të dhëna të sakta e të besueshme dhe në rezultatet e vlerësimit, APAAL harton raporte analitike të sistemit të arsimit të lartë sipas një ose disa aspekteve apo treguesve.
- Agjencia bashkëpunon me institucionet publike dhe private të arsimit të lartë për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke rekomanduar kriteret, metodat dhe indikatorët e përgjithshëm, si dhe kriteret e metodat e përshtatshme për vetëvlerësimin periodik të sistemit. Ajo udhëzon dhe trajnon njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe mban marrëdhënie të vazhdueshme me këto njësi.
- Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë bashkëpunon me rrjetet e agjencive për sigurimin e cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë dhe ato që operojnë në rang ndërkombëtar.
- Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë bashkëpunon me Institucionet e Arsimit të Lartë në vend dhe institucione që lidhen me to, organizata profesionale, institucione që lidhen me tregun e punës, për shkëmbim informacioni dhe ekspertizë duke i përfshirë aktivisht në procesin e vlerësimit të jashtëm.

- APAAL bashkëpunon edhe me këshillat studentore duke i përfshirë këta aktorë në procesin e vlerësimit të jashtëm si dhe për mbledhje informacioni e të dhënash që i shërbejnë vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë në AL në tërësi.
- Në bashkëpunim me KA, APAAL harton në fund të çdo viti një raport të veprimtarisë së saj, i cili i dërgohet Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe më pas bëhet publik brenda 4 mujorit të parë të vitit pasardhës.
- APAAL jep, përmes faqes zyrtare të saj informacion publik të përditësuar mbi statusin e IAL-/programeve lidhur me vlerësimin dhe akreditimin, rezultatet e rankimit dhe të analizave në AL.
- APAAL lëshon Çertifikatën Përfundimtare të Akreditimit pas marrjes së akreditimit.

2. Këshilli i Akreditimit

Këshilli i Akreditimit është organ kolegjal, që kryen veprimtarinë e vetë, pranë Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe organizohet sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Numri i anëtarëve të Këshillit të Akreditimit është 11 (njëmbëdhjetë), nga të cilët pesë anëtarë të këtij këshilli janë propozuar nga institucionet e arsimit të lartë, 3 (tre) ekspertë të fushës, dy nga të cilët janë të huaj, të propozuar nga agjencitë ndërkombëtare të akreditimit, dhe një ekspert, përfaqësues i sektorit privat, një përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, një përfaqësues nga Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Sportit, dhe një student i propozuar nga Këshilli Kombëtar Studentor. Ministri i Arsimit dhe Sportit emëron anëtarët e Këshillit të Akreditimit nga kandidatët e propozuar nga palët e përfaqësuara. Kryetari i këshillit të Akreditimit përzgjidhet nga kandidatët e propozur nga ky këshill. Ai emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozim të Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Këshilli i kryen veprimtaritë e tij në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me rregulloren e tij, e cila miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Sportit. Për çështje të cilat nuk mbulohen nga ekspertiza e anëtarëve të këshillit apo edhe kur gjykohet e nevojshme, Këshilli mund të kërkojë edhe ekspertë ose konsulentë të jashtëm që ta asistojnë për formulimin e vendimeve. Këshilli mbledhet jo më shumë se 9 (nëntë) herë në vit. Anëtari i KA-së, që mungon në 1/3 e mbledhjeve, zëvendësohet.

Këshilli i Akreditimit zhvillon aktivitetin e vet pranë APAAL.

Veprimtaritë kryesore të Këshillit të Akreditimit janë të përcaktuara në rregulloren e jashtme të sistemit të sigurimit të cilësisë. Veprimtaritë kryesore të KA janë të shumta dhe më kryesoret janë:

- Miraton procedurat dhe metodologjinë e vlerësimit, si dhe dokumentet kryesore të përgjithshme dhe të veçanta për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin e programeve të studimit dhe të institucioneve të arsimit të lartë, të propozuara nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, mbështetur në aktet ligjore në fuqi, si dhe duke pasur në konsideratë udhëzimet dhe modelet evropiane përkatëse.

- *Këshilli i Akreditimit*
- *Misioni*
- *Objektivat*
- *Funksionet kryesore*

- Harton raportin e veprimtarive të kryera, në fund të çdo viti, në bashkëpunim me Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë, të cilën ia dërgon Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe e bën publik atë.
- Shqyrton dhe miraton përbërjen e grupit të ekspertëve për çdo vlerësim të jashtëm, që propozohet nga agjencia, pas përzgjedhjes së tyre sipas fushave që do të vlerësojnë nga lista e përgjithshme e ekspertëve.
- Shqyrton, mbështetur në legjislacionin në fuqi, vlerësimet e kryera nga APAAL dhe i rekomandon ministrit hapjen ose jo të programeve të reja të studimit, nënstitucionet publike të arsimit të lartë.
- Shqyrton raportin përfundimtar të një vlerësimi të jashtëm dhe jep rekomandimet përkatëse për akreditimin, që i dërgohen Ministrit të Arsimit dhe Sportit
- Shqyrton ankesat apo pretendimet për raportin e vlerësimit të jashtëm nga subjekti i interesuar. Këshilli vlerëson materialet e paraqitura, si edhe pretendimet e palës dhe vendos t'i marrë ato në konsideratë ose jo, ose vendos të dërgojë ndonjë grup tjetër vlerësuesish për vlerësim në institucion. Në të gjitha rastet, mendimet e ekspertëve/anëtarëve të këshillit shprehen në procesverbal dhe vendimi përfundimtar duhet të jetë i argumentuar. Vendimit të rekomandimit i bashkëngjitet edhe mendimi kundër. Në procesin e marrjes së vendimit, Këshilli i Akreditimit mund të kërkojë nga agjencia dhe institucioni që vlerësohet, informacione shtesë apo saktësime.
- Në mbledhjet e Këshillit të Akreditimit merr pjesë, pa të drejtë vote, Drejtori i Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë.
- Formulon gjykimin e tij, mbështetur në rezultatet e vlerësimit të kryera nga agjenci të tjera pjesë e ENQA.
- Përcakton parimet, kriteret dhe procedurat, mbështetur edhe nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe në bazë të rekomandimeve përkatëse evropiane, për njohje reciproke të akreditimit, të fituar nga agjenci të tjera, si dhe për procedurat e akreditimit të programeve të përbashkëta ndërmjet dy a më shumë institucioneve shqiptare të arsimit të lartë, apo në bashkëpunim me një institucion të huaj të arsimit të lartë.

3. Organizimi i APAAL

Në bazë të vendimit të KM, nr. 424, datë 02.06.2010 "Për miratimin e strukturës së Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë", APAAL është riorganizuar në tre sektorë dhe numri i punonjësve aktualisht është 15.

- *Organigrama*
- *Sektorët e APAAL*
- *Detyrat*
- *Punonjësit*

- *Sektori i Promovimit dhe Vlerësimit të Cilësisë, SPVC*

SPVC, është i përbërë nga përgjegjësi i sektorit dhe specialistë të cilët janë të diplomuar në disa fusha studimit. Mbështetje në këtë sektor japin ekspertët e fushave të ndryshme akademike, të cilët angazhohen për të kryer vlerësimet e jashtme. Një nga detyrat kryesore të këtij sektori është vlerësimi i institucioneve të reja të arsimit të lartë (publik dhe privat) si dhe të programeve të reja të studimit në kuadrin e hapjes/licensimit të tyre. Ky sektor gjithashtu, ka si detyrë parësore organizimin dhe monitorimin e procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, që ofrojnë këto institucione (publike dhe private).

- *Sektori i Statistikave dhe Analizave, SSA*

SSA, është strukturë e re e krijuar në vitin 2010, me miratimin e rregullores së re të sistemit të akreditimit dhe sigurimit të cilësisë. Ky sektor ka një rol të veçantë dhe mjaft të rëndësishëm në strukturën e APAAL dhe sistemin e arsimit të lartë në tërësi. Detyrat themelore të këtij sektori janë: rankimi/renditja e institucioneve të arsimit të lartë dhe e programeve të studimit, analiza cilësore e krahasuese në arsimin e lartë për institucionet, programet apo aspekte të veçanta të tyre si stafet akademike, kërkimi shkencor, facilitetet etj. Mbledhjen e të dhënave për të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe krijimin e databazës kombëtare për IAL-të në tërësi. Këto të dhëna shfrytëzohen nga institucionet e tjera vendimmarrëse e politikbërëse për hartimin e politikave në arsimin e lartë me qëllim përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë në vend. Një rol të rëndësishëm në aktivitetin e këtij sektori zë përgatitja e materialeve, raporteve dhe të dhënave për publikim dhe informim. Stafi i këtij sektori angazhohet gjithashtu në të gjitha aktivitetet dhe proceset që APAAL zhvillon në fushën e arsimit të lartë.

- *Sektori i Shërbimeve dhe Publikimit, SShP*

- *Këshilli i Akreditimit dhe përbërja*

Ky sektor ka në përbërjen e vet 3 punonjës dhe përgjegjësin e sektorit. Pjesë e këtij sektori janë financa dhe protokoll/arshiva e APAAL. Aktiviteti i tij kryesor është fokusuar në mbështetjen financiare dhe logjistike të APAAL, KA dhe ekspertëve vendas dhe të huaj. Ky sektor kryen gjithashtu publikimin e materialeve dhe botimeve të APAAL/KA në kuadër të informimit të publikut.

Gjithashtu, mbështetja për organizimin e aktiviteteve trajnuese dhe promovuese të cilësisë në Arsimin e Lartë, në bashkëpunim me të gjithë faktorët e interesuar, është një nga detyrat e rëndësishme të këtij sektori.

- *Përbërja e Këshillit të Akreditimit*

Aktualisht Këshilli i Akreditimit ka në përbërjen e vet 11 anëtarë, personalitete të njohura në fushën e arsimit të lartë. Dy prej anëtarëve të KA janë ekspertë të huaj, të njohur në fushën e arsimit të lartë dhe sigurimit të cilësisë.

Në funksionet e veta, KA bashkëpunon me Këshillin e Arsimit të Lartë dhe Sportit për të formuluar për Ministrin e Arsimit dhe Sportit rekomandime për sigurimin e cilësisë në fushën e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor. I gjithë aktiviteti i KA, përfshirë edhe atë financiar, sigurohet dhe drejtohet nga stafi i APAAL

4. Ekspertët e vlerësimit të jashtëm

- *Ekspertët e vlerësimit*
- *Procedurat përzgjedhjes*
- *Aplikimi online*

Në ushtrimin e veprimtarisë së saj të vlerësimit, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Këshilli i Akreditimit aktivizojnë dhe bashkëpunojnë me ekspertë të jashtëm të vlerësimit dhe/apo konsulentë, të cilët duhet të kenë kualifikimet e duhura për llojin e vlerësimit që kryejnë, si dhe duhet të jenë të pavarur për të dhënë një gjykim të drejtë dhe pa ndikime, duke shmangur çdo konflikt të mundshëm interesi.

APAAL dhe KA përditësojnë e bazën e të dhënave të ekspertëve të vlerësimit dhe të konsulentëve, vendas apo të huaj. Ndër kriteret kryesore të përfshirjes së ekspertëve vendas apo të huaj në proceset e vlerësimit dhe akreditimit janë: kualifikimet e duhura për llojin e vlerësimit që do të kryejnë, si dhe duhet të jenë të pavarur për të dhënë një gjykim të drejtë dhe pa ndikime, duke shmangur çdo konflikt të mundshëm interesi, të jetë figurë e njohur në fushën përkatëse të shkecës, të ketë përvojë prej të paktën 5 (pesë) vjetësh në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor në një nga fushat, të ketë të paktën gradën shkencore “Doktor”, të ketë përvojë në sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, të ketë integritet të lartë personal dhe profesional, të ketë përvojë ndërkombëtare të fituar përmes studimeve pasuniversitare, apo kualifikim shkencor në universitete a qendra kërkimore perëndimore, të nënshkruajë një deklaratë, ku garanton për pavarësinë në veprimtarinë e tij dhe mungesën e konfliktit të interesit, të trajtojnë të gjitha materialet dhe rezultatet e vlerësimit si krejtësisht konfidenciale.

Pas pranimit si ekspert i vlerësimit, ata pajisen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe të institucioneve përkatëse për vlerësimin e të cilëve ekspertët përzgjidhen. E gjithë procedura, veprimtaria në dosjen e vetëvlerësimit dhe vizitat në vend, vlerësuesi harton raportin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë, të cilin e dorëzon për procedura të mëtejshme në Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

Anëtarë të grupeve të vlerësimit janë dhe ekspertë të huaj. APAAL dhe KA mund të thërrasin ekspertë/konsulentë të jashtëm, për t'i ndihmuar me mendime dhe propozime për kriteret dhe metodat e vlerësimit, për rrugët dhe format e rritjes së cilësisë në arsimin e lartë,

si dhe hartimin e dokumenteve që ndihmojnë procesin në tërësi. Një nga këto aktivitete është dhe ekspertiza gjatë proceseve të rankimit.

5. Licensimi i institucioneve dhe programeve

- *Informacione*
- *IAL*
- *Programet në IAL Publike*
- *Programet në IAL Private*

Aktualisht në vendin tonë janë të licensuara 59 institucione të arsimit të lartë të ndara siaps tabelës së mëposhtme:


| IAL dhe statusi aktual | | |
|-------------------------|-------------|-------------|
| | IAL Publike | IAL Private |
| Universitete | 12 | 7 |
| Shkolla të larta | 0 | 26 |
| Akademi | 2 | 6 |
| Kolegje profesionale | 0 | 5 |
| Qendra ndëruniversitare | 1 | 0 |
| Totali | 15 | 44 |

| Programe të ofruara në institucionet publike e private | | | |
|--|-------------|-------------|-------|
| | IAL Publike | IAL Private | TOTAL |
| Dipl. 2 vjecare | 9 | 4 | 13 |
| BSc | 240 | 317 | 557 |
| MP | 128 | 145 | 273 |
| MSc | 174 | 196 | 370 |
| SPA | 23 | 2 | 25 |
| DR | 96 | 20 | 116 |

| IAL Publike të licensuara 2010 -2013 | | | | |
|--------------------------------------|------|------|------|-------|
| 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | TOTAL |
| 0 | 0 | 1 | 1 | 2 |

| IAL Private të licensuara 2010 -2013 | | | | |
|--------------------------------------|------|------|------|-------|
| 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | TOTAL |
| 4 | 7 | 2 | 0 | 13 |

- *Informacion i përgjithshëm*



Numri i vlerësimeve në kuadrin e licensimit të IAL/Programeve të reja, krahasuar me vitet e mëparshme ka qënë më i vogël (shih në mënyrë krahasuese tabelat e mëposhtme).

- *Aplikimi për licensim*

- *Vleresimi*

Vlerësime të kryera në IAL Publike

| | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | Total |
|---------------|------|------|------|------|-------|
| Dip.2 vjecare | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 |
| Bsc | 15 | 1 | 4 | 8 | 28 |
| MP | 8 | 8 | 9 | 2 | 27 |
| MSc | 17 | 8 | 0 | 1 | 26 |
| Dr | 17 | 4 | 0 | 0 | 21 |
| SPA | - | - | - | - | - |


Vlerësime të kryera në IAL Private

| | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | Total |
|---------------|------|------|------|------|-------|
| Dip.2 vjecare | | | | | |
| Bsc | 2 | 2 | 0 | 0 | 4 |
| MP | 29 | 65 | 43 | 8 | 145 |
| MSc | 11 | 30 | 29 | 13 | 83 |
| Dr | 28 | 33 | 36 | 20 | 117 |
| SPA | 0 | 3 | 12 | 4 | 19 |


| | | | | | |
|---------------|---|---|---|---|---|
| Dip.2 vjecare | 0 | 0 | 0 | 2 | 2 |
|---------------|---|---|---|---|---|

▪ *Vlerësimet
2010 - 2013*

Numri i programeve të vleresuara në kuadrin e licensimit 2010-2013



Numri i programeve të vleresuara në kuadrin e licensimit 2010-2013



Për vitin 2013, numri i dosjeve të shqyrtuara në kuadër të vlerësimit ka qënë:

Janë realizuar 121 raporte të vlerësimit teknik, për ciklin e parë, ciklin e dytë dhe ciklin e tretë të studimit.

- *Vlerësime të detajuara në 2013*

- Në IAL publike janë vlerësuar gjithsej 50 programe të ciklit të parë, ciklit të dytë dhe ciklit të tretë të studimit; më konkretisht: 20 Bsc, 15 Mp, 11 Msc dhe 4 Dr.
- Në IAL private janë vlerësuar gjithsej 71 programe të ciklit të parë, ciklit të dytë dhe ciklit të tretë të studimit; më konkretisht: 17 Bsc, 18Mp, 33 Msc dhe 3 Dr
- Janë realizuar 14 raporte të organizimit institucional të IAL-ve private dhe publike

Më hollësisht, gjatë perudhës 2012-2013, janë kryer këto procese:

Nga të dhënat e mësipërme, rezulton se aplikimet për çdo procedurë të zhvilluar nga APAAL, janë në numër më të madh në IAL-të private.

Për vitin 2013, me vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 48, datë 23.1.2013 “Për krijimin e Universitetit Të Mjekësisë, Tiranë (UMT), u riorganizuan dy fakultete të Universitetit të Tiranës në Universitetin Mjekësor të Tiranës i cili ka tashmë 5 fakultete.

Procedurat e vlerësimit janë shqyrtuar në mbledhjet e KA dhe janë publikuar në faqen zyrtare të APAAL (shih www.aaal.edu.al).

- *Procese të vlerësimit të jashtëm në IAL*
- *RVB & RVJ*

Në 2013 janë kryer në kuadër të akreditimit këto procedura:

- Procesi i vlerësimit të jashtëm, në kuadër të akreditimit të IAL-së në “UNIVERSITETIN EUROPIAN të TIRANES” për programe studimi të ciklit të dytë
- Monitorimin e procesit të vlerësimit të jashtëm, në kuadër të akreditimit të IAL-së “UNIVERSITETI POLIS” për programe të ciklit të dytë të studimit.
- Procesi i të vlerësimit të jashtëm, në kuadër të akreditimit të Institucionit dhe të 18 programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë të studimit të SHLUP “BEDER”
- Procesi i të vlerësimit të jashtëm, në kuadër të akreditimit të IAL-së SHLUP “KRISTAL” për programe të ciklit të parë të studimit.
- Procesi i të vlerësimit të jashtëm, në kuadër të akreditimit të IAL-së SHLUP “PLANETARI” për programe të ciklit të dytë të studimit.
- Procesi i të vlerësimit të jashtëm, në kuadër të akreditimit të IAL-së SHLUP “ILLYRIA” për programe të ciklit të parë dhe te dyte të studimit.
- Procesi i të vlerësimit të jashtëm, në kuadër të akreditimit të “ALBANIAN UNIVERSITY” për programe të ciklit të parë dhe te dyte të studimit (Filiali Berat)
- Procesi i të vlerësimit të jashtëm, në kuadër të akreditimit të IAL-së SHLUP “TBU” për programe të ciklit të parë dhe te dyte të studimit.
- Procesi i të vlerësimit të jashtëm, në kuadër të akreditimit të IAL-së SHLUP “UNYT” për programe të ciklit të parë dhe te dyte të studimit.
- Procesi i të vlerësimit të jashtëm, në kuadër të akreditimit të IAL-së SHLUP “UNT” për programe të ciklit të parë dhe te dyte të studimit.
- Procesi i të vlerësimit të jashtëm, në kuadër të akreditimit të IAL-së SHLUP “LUARASI” për programe të ciklit të dytë të studimit.
- Procesi i të vlerësimit të jashtëm, në kuadër të akreditimit të IAL-së SHLUP “REALD” për programe të ciklit të parë të studimit.
- Procesi i të vlerësimit të jashtëm, në kuadër të akreditimit të IAL-së SHLUP “ARGENT” për programe të ciklit të parë të studimit.
- Procesi i të vlerësimit të jashtëm, në kuadër të akreditimit të IAL-së SHLUP “GJON BUZUKU” për programe të ciklit të parë të studimit.

- Procesi i të vlerësimit të jashtëm, në kuadër të akreditimit të IAL-së SHLUP “NEË GENERATION” për programe të ciklit të parë të studimit.
- Procesi i të vlerësimit të jashtëm, në kuadër të akreditimit të IAL-së SHLUP “IVOCLAR & VIVADENT” për programe të ciklit të parë të studimit.
- Kontrolli i raportit të vlerësimit të brendshëm, Msc në "Marrëdhënie Ndërkombëtare- Studime europiane" të Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”.
- Kontrolli i raportit të vlerësimit të brendshëm, Msc në "Administrim Shëndetësor” të Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”.
- Kontrolli i raportit të vlerësimit të brendshëm, Mnp "Menaxhim për Funkcionet e Koordinimit” të Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”.
- Kontrolli i raportit të vlerësimit të brendshëm, MND "Organizimi dhe drejtimi i institucioneve shëndetësore dhe shërbimeve” të Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”.

Në infomacionin që APAAL disponon, nuk ka institucione publike në proces vlerësimi nga agjenci të huaja anëtare të ENQA sikundër parashikon ligji i arsimit të lartë përveç institucionit privat “Nehemia”, i cili ka zhvilluar procesin e vlerësimit për akreditim, me agjencinë gjermane “FIBAA”. Raporti i vlerësimit të jashtëm është dërguar në APAAL dhe KA është marrë vendimi i akreditimit.

Organizimi i takimeve me institucionet publike e private, diskutimi për mekanizmat e rritjes së cilësisë dhe të monitorimit të cilësisë, orientimi i drejtë i programeve mësimore në përputhje me tregun e punës, ka qënë pjesë e vazhdueshme gjatë gjithë proceseve të akreditimeve të zhvilluara.





















Vetëm për vitin 2013, APAAL ka kryer në total 15 trajnime të grupeve (rreth 93 persona) të sigurimit të cilësisë të institucioneve që janë në proces akreditimi.

Situata aktuale e akreditimeve institucionale për ccdo institucion të

- *Vendime tw KA*
- *Informacione për cdo IAL*

| Nr | IAL | Akreditim Institucional | Akreditim njësisish (fakultete/qendra) | Në proces akreditimi | Institucione që janë brenda |
|----|-----|-------------------------|--|----------------------|-----------------------------|
|----|-----|-------------------------|--|----------------------|-----------------------------|

| | | | | | afateve ligjore për akreditim |
|----|---|--|------------------------|--|-------------------------------|
| 1 | Universiteti i Neë York-ut në Tiranë | | | | |
| 2 | SHLUP "Luarasi" | | | | |
| 3 | Universiteti Privat "Albanian University" | | | | |
| 4 | Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" | | | | |
| 5 | Akademia e Filmit dhe Multimedias "Marubi" | | | | |
| 6 | SHLUP "Universiteti "Marin Barleti"" | | | | |
| 7 | SHLUP "Universiteti Kristal" | | | | |
| 8 | SHLUP "Justiniani I" | | Fakulteti i Drejtësisë | | |
| 9 | SHLUP "Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi" | | | | |
| 10 | Universiteti European i Tiranës | | | | |
| 11 | SHLUP "Justicia" | | Fakulteti i Drejtësisë | | |
| 12 | SHLUP "Aldent" | | | | |
| 13 | SHLUP "Medikadent" | | | | |
| 14 | SHLUP "Ëisdrom University" | | | | |
| 15 | Universiteti Polis | | | | |
| 16 | Universiteti Epoka | | | | |
| 17 | SHLUP "Shkolla e Lartë Amerikane e Tiranës" | | | | |
| 18 | SHLUP "ISSAT" | | | | |
| 19 | SHLUP "Shkolla e Lartë Nehemia" | | | | |
| 20 | SHLUP "Shkolla e Lartë Nëna Mbretëreshë, Geraldinë" | | | | |

| | | | | | |
|----|--|---|--|---|---|
| 21 | SHLUP "Shkolla e Lartë ILLYRIA" | |  Fakulteti i Drejtësisë | | |
| 22 | Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë |  | | | |
| 23 | Kolegji Profesional Privat "Ivoclar Vivadent&Partners" |  | | | |
| 24 | SHLUP "Pavarësia" |  | | | |
| 25 | SHLUP "Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës" |  | | | |
| 26 | Kolegji Profesional Privat, "Neë Generation" |  | | | |
| 27 | SHLUP "Vitrina" |  | | | |
| 28 | Kolegjet Profesionale, Private, "Medicom" |  | | | |
| 29 | Shkolla e Lartë Private e Edukimit |  | | | |
| 30 | SHLUP "Universiteti Planetar i Tiranës" |  | | | |
| 31 | SHLUP "Logos" |  | | | |
| 32 | SHLUP "Gjon Buzuku" |  | | | |
| 33 | SHLUP "Universiteti Metropolitan Tirana" | | |  | |
| 34 | SHLUP "Universiteti Elite" | | | | |
| 35 | SHLUP "Tirana Business University" |  | | | |
| 36 | SHLUP "Hëna e plotë" (BEDËR) |  | | | |
| 37 | Akademia Profesionale e Biznesit |  | | | |
| 38 | Akademia e Studimeve te Aplikuara, Durrës | | | |  |
| 39 | Akademia e Studimeve të Aplikuara "REALD" |  | | | |
| 40 | SHLUP "Instituti Kanadez i Teknologjisë" | | |  | |
| 41 | Akademia | | |  | |

| | | | | | |
|----|--------------------------------------|--|--|--|--|
| | Pedagogjike | | | | |
| 42 | Akademia e Ndërtimit e Tiranës | | | | |
| 43 | Kolegji profesional "ARGENT" | | | | |
| 44 | Kolegji Profesional i Sporteve, Fier | | | | |
| 45 | Universiteti i Tiranës | | | | |
| 46 | Universiteti Politeknik i Tiranës | | | | |
| 47 | Universiteti Bujqësor i Tiranës | | | | |
| 48 | Universiteti "Aleksandër Xhuvani" | | | | |
| 49 | Universiteti "Luigj Gurakuqi" | | | | |
| 50 | Universiteti "Eqerem Çabej" | | | | |
| 51 | Universiteti "Fan S. Noli" | | | | |
| 52 | Universiteti "Ismail Qemali" | | | | |
| 53 | Qendra e Studimeve Albanologjike | | | | |
| 54 | Universiteti "Aleksandër Moisiu" | | | | |
| 55 | Akademia e Mbrojtjes "Spiro Moisiu" | | | | |
| 56 | Universiteti i Arteve | | | | |
| 57 | Universiteti i Sporteve të Tiranës | | | | |
| 58 | Akademia e Arteve, Shkodër | | | | |
| 59 | Kolegji Profesional i Sporteve, Fier | | | | |
| 60 | Universiteti i Mjekësisë, Tiranë | | | | |

- Për vlerësimin institucional, të paktën një ekspert ka qënë i huaj.
- APAAL ka angazhuar gjatë 2013 rreth 120 ekspertë vendas dhe 20 ekspertë huaj.
- 14 akreditime institucionale janë kryer me ekspertë të huaj
- Janë të publikuara të gjitha raportet e vlerësimit të jashtëm për periudhën 2012 – 2013

- Njoftimi për aplikim për ekspert ndërkombëtar dhe aplikimi on line ka qënë i mundshëm në në faqen zyrtare të APAAL

Raporti i vlerësimit të brendshëm institucional dhe i jashtëm, dorëzohet në APAAL në gjuhën angleze. Për cdo raport të vlerësimit të jashtëm stafi i APAAL ka vënë në dispozicion të ekspertëve të huaj të KA, analizën SWOT të përkthyer në anglisht.

Me urdhër të titullarit të institucionit, të gjitha raportet e vlerësimit të jashtëm të hartuara gjatë vitit 2013 janë publikuar në faqen zyrtare të APAAL. Kjo ndihmon në rritjen e transparencës ndaj vlerësimeve në kuadër të akreditimit dhe gjithashtu rrit cilësinë e proceseve të zhvilluara nga APAAL dhe ekspertët e vlerësimit. APAAL ka përmirësuar vazhdimisht dokumentacionin për vlerësim dhe akreditim. Janë rishikuar formatet e hartimit të raporteve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm në kuadër të akreditimit. Në këto formate janë përmbledhur të gjitha standartet dhe kriteret e të tre cikleve të studimit, si dhe standartet europiane të cilësisë.

7. Analiza në arsimin e lartë dhe sistemi i menaxhimit të të dhënave

- *Tw dhuna pwr AL*
- *Analiza statistikore*

Në vitin 2013 APAAL ka përfunduar riorganizimin dhe strukturimin e modelit të renditjes së universiteteve të zhvilluar gjatë vitit 2011 në bashkëpunim me kompaninë gjermane CHE (Center for Higher Education).

Kujtojmë se një nga problemet më të mëdha i hasur në procesin e parë, ka qenë besueshmëria e të dhënave të marra nga pyetësorët në tërësi dhe ai i studentëve në veçanti. Disa nga pyetësorët janë modifikuar dhe janë shtuar pyetje të reja në pyetësorët e përdorur në vitin 2011. Stafi i Sektorit të statistikave dhe Analizave, ka zhvilluar më tej këtë model duke finalizuar tashmë versionin e ri të renditjes së univeristeteve në Shqipëri. Këto rezultate janë paraqitur në forumin për renditjen e universiteteve nga IREG në Poloni, maj 2013. Gjithashtu, është punuar paralelisht për përshtatjen e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e proceseve të mëtejshme. Në vitin 2013, përfundoi sistemi i menaxhimit të APAAL. Në shtator të vitit 2013, SSA ka filluar plotësimin e databazës qendrore të sistemit me të dhëna të besueshme nga të gjitha IAL në vend.

Baza e të dhënave të marra gjatë procesit të rankimit, është rishikuar, janë shtuar dhe korigjuar të dhënat jo të sakta apo të munguara për IAL të ndryshme.

Është kryer analiza e sistemeve të informimit që aktualisht IAL disponojnë. Janë vërejtur problematika të shumta duke filluar nga mosekzistenca e infrastrukturës së informimit deri në informim të mangët ose jo real të studentëve dhe publikut nga ana e institucioneve.

Janë kryer disa analiza dhe përpunime statistikore në funksion të institucioneve të ndryshme që kanë kërkuar të dhëna në lidhje me IAL dhe Programet, psh. Për Prokurinë e Përgjithshme, Policinë e Tiranës, Univeristetin Mjekësor etj.

Shumë të dhëna statistikore janë tashmë të publikuara në faqet zyrtare të internetit, duke dhënë informacion të detajuar për ccdo institucion apo program në vend.

Për përmirësimin e mëtejshëm të proceseve të rankimit dhe analizave, APAAL, ka qenë në kontakt me bashkëpunëtorët ndërkombëtarë për të dhënë eksperiencën e tyre për ndërtimin e sistemit të menaxhimit të pyetësorëve dhe të rankimit të personalizuar. Stafi i APAAL ka marrë pjesë në forumet “U-Multirank”, të iniciuar nga Komisioni Europian në qershor të vitit 2009 dhe të zhvilluar edhe këtë vit në Bruksel.

Procesi i mbledhjes së të dhënave nga IAL ka qenë i vazhdueshëm për IAL dhe programet e ofruara, proceset e vlerësimit, akreditimit, rankimit dhe analizave në arsimin e lartë, statistika për studentët, stafet akademike, kërkimin shkencor, facilitetet etj.

Kjo bazë të dhënash e përfshirë në sistemin informatik për menaxhimin e APAAL mundëson kryerjen e disa procedurave/aktiviteteve kryesore në kuadrin e vlerësimit, akreditimit dhe rankimit të institucioneve/programeve të arsimit të lartë si: vlerësime të programeve/ institucioneve në kuadrin e licencimit/hapjes së tyre. Vlerësime institucionale dhe programeve të reja në institucionet ekzistuese, vlerësime në kuadrin e akreditimeve të reja dhe periodike në IAL, menaxhim të procesit të rankimit/renditjes së IAL-ve, analiza në arsimin e lartë të programeve dhe IAL-ve, menaxhim të komunikimeve elektronike e postare, menaxhim aplikimesh e dosjesh, evoluim në kohë të proceseve në etapa të ndryshme, informacion të besueshëm në kohe reale, menaxhim të proceseve të renditjes, klasifikimit e akreditimit, analiza, komunikim midis punonjësve, menaxhim, detyrat në kohë, komunikimi me institucionet, komunikimi me ekspertët. Mjaft module dhe portale të reja të dedikuara, janë krijuar në këtë faqe të cilat japin një informacion mjaft të detajuar për të gjitha proceset që zhvillon APAAL.

Megjithatë, ende ekzistojnë disa problematika që duhen zgjidhur me qëllim krijimin plotësimin ekrereve të institucioneve ndërkombëtare që operojnë në këtë drejtim.

Më hollësisht:

- *Përmirësimet*
 - *Mangësia të akteve nënligjore që rregullojnë procesin e rankimit apo analizave*
 APAAL nuk ka të përcaktuar me akte nënligjore procedurat sipas të cilave do të sigurohet mbështetja financiare. Në buxhetet vjetore të APAAL nuk është parashikuar shpota financiar për të kryer një proces rankimi. Gjithashtu edhe të ardhurat dytësore nga procesi i

akreditimit, APAAL nuk mund t'i shpenzojë për procese të tjera përveç akreditimit.

- *Ndarja e procesit të akreditimit nga ai i rank-imit*

Akreditimi dhe rankimi janë dy procese të sigurimit të cilësisë në AL. CHE ka propozuar të jenë procese të ndara e për rrjedhojë rankimi të zhvillohet nga organizma të ndryshëm dhe të pavarura nga të gjitha institucionet dhe mekanizmat etjerë të arsimit të lartë në mënyrë që të rritet besueshmëria e palëve të interesuara dhe publikut. Rekomandimi kryesor është ndarja e SSA nga struktura e APAAL, si një njësi e veçantë e fokusuar tërësisht në renditjen dhe analizat në arsimin e lartë e cila deri tani nuk është arritur të realizohet. Ky rekomandim nuk është plotësuar pasi nuk është në kompetencën e APAAL.

- *Përmirësimi i infrastrukturës për menaxhimin e proceseve të renditjes dhe analizave.*

Ky rekomandim i bërë nga CHE në korrik të vitit 2011, bazohet në vizitën e ekspertëve gjermanë në APAAL dhe në specifikën që kanë këto dy procese të cilat realizohen on line me të dhëna të vetëdeklaruar nga institucionet. Deri në këtë moment APAAL ka bërë hapa pozitivë në përmirësimin e infrastrukturës për këtë qëllim. APAAL ka përfunduar Sistemin elektronik të menaxhimit të proceseve “APAAL Management System”, projekt i nisur në vitin 2011 dhe i përfunduar në qershor të vitit 2013. Është ndërtuar baza databaza e të dhënave që do t'ju shërbejë këtyre proceseve dhe në veçanti atij të rankimit. Për sa i përket sistemeve të informimit APAAL ka krijuar infrastrukturën e duhur për informimin dhe publikimin e rezultateve. APAAL ka faqe zyrtar etë dedikuar për publikimin e rezultateve të renditjes së universiteteve. (www.albranking.com)

- *Përmirësimi i kuadrit ligjor*

Për metodologjinë dhe procedurat që do të ndiqet për ranking/rating/analiza në të ardhmen aktualisht nuk ka akte nënligjore të cilat rregullojnë këtë proces. Këshilli i Akreditimit si institucioni vendimmarrës dhe politikbërës nuk ka marrë nisma për

plotësimin apo përmirësimin e kuadrit ligjor në funksion të proceseve të renditjes.

Në lidhje me trajnimin e stafit të APAAL, ccdo vit 2011 – 13, ccdo vit është mundësuar pjesëmarrja në Simpoziumin vjetor për renditjen e universiteteve që është zhvilluar në Bruksel në kuadër të projektit “University Multirank”. Në maj 2013, APAAL mori pjesë në aktivitetin: “IREG Forum on University Rankings: *Methodology under scrutiny*”, duke prezantuar punën e bërë nga APAAL gjatë periudhës 2011 – 2013, “*Improving the ranking model of the Albanian higher education institutions*”, <http://ëëë.ireg-observatory.org>

8. Aktiviteti i Këshillit të Akreditimit dhe ekspertëve të jashtëm

- *Aktiviteti i KA 2013*

Këshilli i Akreditimit ushtron aktivitetin e vet në ambientet e APAAL. Mbledhjet e KA organizohen në bazë të një kalendari të hartuar në përputhje me numrin e aplikimeve që janë për t'u shqyrtuar.

Në lidhje me aktivitetin kryesor të KA, disa nga veprimat kryesore të të tij të zhvilluara gjatë vitit 2012 janë:

Miratimi i procedurave dhe metodologjisë së vlerësimit, si dhe dokumentet kryesore të përgjithshme dhe të veçanta për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin e programeve të studimit dhe të institucioneve të arsimit të lartë, të propozuara nga APAAL, mbështetur në aktet ligjore në fuqi, si dhe duke pasur në konsideratë udhëzimet dhe modelet evropiane përkatëse. Veçojmë formatet e raporteve të vlerësimit për të tre ciklet e studimit në përputhje me standardet shtetërorë të cilësisë. Ndërkohë, KA ka shqyrtuar dhe miratuar në çdo rast përbërjen e grupit të ekspertëve për çdo vlerësim të jashtëm, të propozuar nga APAAL. Pas përzgjedhjes së tyre sipas fushave që do të vlerësojnë, nga lista e përgjithshme e ekspertëve, KA ka shqyrtuar dosjet me vlerësimet e kryera nga APAAL dhe ekspertët, dhe i ka rekomanduar Ministrit, hapjen ose jo të programeve të reja të studimit, në institucionet publike/private të arsimit të lartë duke marrë vendimet përkatëse të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të APAAL për KA.

- *Mbledhjet e KA*

Në total, Këshilli i Akreditimit ka zhvilluar 4 mbledhje dhe ka marrë 127 vendime, për licencim, akreditim dhe folloë-up. Numri i vlerësimeve të kryera nga KA është 190.

- *Vndimet e KA*

| Vendime të KA në total | | | | | | | | |
|------------------------|---------------------|--------|------------|-----------|--|--|--|----|
| | Mbledhjet e KA 2013 | | | | | | | |
| | 11 Janar | 03 Maj | 03 Qershor | 18 Korrik | | | | |
| IAL Privat | 14 | 31 | 6 | 11 | | | | 62 |

- *Mbështetja e APAAL për KA*
- *Mbështetja e APAAL për ekspertët*

| | | | | | | | | | | | | |
|-----------------------|---|---|---|---|----|----|----|---|----|---|-----|-----|
| BSC | 7 | 6 | | 3 | 16 | 21 | 9 | 3 | 5 | | 38 | 54 |
| MP | 7 | 8 | 2 | | 17 | 23 | 8 | 7 | 1 | | 39 | 56 |
| MSC | 9 | 3 | 2 | | 14 | 28 | 11 | 2 | | | 41 | 55 |
| Ma | | | | | | | | | | | | |
| Program Jouniversitar | | | | | | | | | | | | |
| Diploma Profesionale | 1 | | | | 1 | | 1 | | | | 1 | 2 |
| DR | 2 | | | 2 | 4 | 3 | | | | | 3 | 7 |
| SPA | | | | | | 1 | | | | | 1 | 1 |
| Hapje Fakulteti | 1 | | | | 1 | 3 | | | | | 3 | 4 |
| Fakulteti | | | | | | | | | 10 | | 10 | 10 |
| IAL | | | | | | | | | | 1 | 1 | 1 |
| Total | | | | | 53 | | | | | | 137 | |
| | | | | | | | | | | | | 190 |

Një nga mbështetjet kryesore për KA ka qënë dhe vënia në dispozicion në gjuhën angleze analizën SWOT të të gjitha raporteve të vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit.

Këshilli i Akreditimit, në çdo aktivitet, ka mbështetjen financiare dhe logjistike të APAAL. Një nga specialistët e agjencisë luan rolin e sekretariatit të KA, i cili kryhen ndër të tjera këto funksione: përgatit axhendën e mbledhjeve dhe aprovimin e tyre, njofton anëtarët e Këshillit të Akreditimit (për axhendën, në mbledhjen përkatëse dhe materialet që do të shqyrtohen etj.), përgatit dosjet dhe harton vendimet për programe/institucione private dhe programe/institucione publike, përgatit dosjet dhe harton vendime dhe dokumente të tjera zyrtare të KA, informon Këshillin e Akreditimit me kërkesat e reja për

akreditim, dërgon listat e ekspertëve, të propozuar nga Drejtori i APAAL, komunikon në emër të KA me institucionet e tjera, etj. Aktiviteti financiar i KA sigurohet nga APAAL, nga të ardhurat e vlerësimit dhe akreditimit. Asistenca logjistike si kancelari, printer, fotokopje, kompjutera etj, po ashtu sigurohen nga APAAL.

APAAL është organi kryesor që koordinon jo vetëm aktivitetin e KA dhe ekspertëve por vendos në dispozicion të tyre të gjitha facilitetet e nevojshme, për zhvillimin me normalitet të procesit të tyre të punës. Ndërkohë, gjatë vizitave në IAL, një nga specialistët e APAAL mundëson komunikimin dhe përkthimin për ekspertët e jashtëm. Agjencia organizon mbledhjet e Këshillit të Akreditimit, përgatit axhendën e takimeve, programin e mbledhjeve, përgatit dhe shpërndan informacionin antarëve të Këshillit dhe përgatit dokumentin final në emër të Këshillit përpara se ai të shqyrtohet e miratohet. Agjencia kryen gjithashtu të gjithë korrespondencën me institucionet e tjera në emër të Këshillit të Akreditimit dhe publikon të gjithë dokumentat e tij zyrtarë në faqen e internetit.

Në zbatim të ligjit të arsimit të lartë dhe në shërbim të rritjes së cilësisë së vlerësimit, APAAL bashkëpunon me ekspertë të jashtëm për vlerësimin dhe akreditimin e institucioneve/programeve në arsimin e lartë. APAAL bashkëpunon me ekspertë të fushave të ndryshme vendas dhe të huaj. Lista e ekspertëve pasurohet dhe shtohet me emra të rinj çdo vit. Përveç kërkesës së dërguar IAL për ekspertë të njohur në fusha të ndryshme, APAAL u ka dhënë mundësi aplikimi elektronike të gjithë të ekspertëve të interesuar, vendas apo të huaj. Për të gjithë ekspertët e rinj apo ekzistues, trajnimi nga APAAL dhe ekspertët e huaj ka qënë i vazhdueshëm veçanërisht për njohjen me procedurat e vlerësimit dhe akreditimit dhe me standartet e reja shtetërore të cilësisë. Janë kryer trajnime në ambientet e APAAL dhe u është vënë në dispozicion materiale e botime të agjencisë që lidhen me proceset kryesore të APAAL.

APAAL mbështet financiarisht veprimtarinë e ekspertëve të jashtëm në lidhje me pagesën duke u bazuar në aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi. Gjatë gjithë proceseve të vlerësimit/akreditimit/rankimit, APAAL është kujdesur vazhdimisht të shmangë konfliktin e interesit që kanë ekspertët me IAL të ndryshme. Për këtë arsye jo vetëm deklarohet nga eksperti pozicioni i tij në lidhje me një IAL, por në kontratën e re është parashikuar një pikë e cila paraqet një lloj deklaratë të ekspertit në

lidhje me konfliktin e interesit. Megjithatë jo në çdo rast është arritur të shmangët plotësisht një fenomen i tillë. Në fusha të veçanta, numri i ekspertëve është relativisht i vogël prandaj angazhimi i ekspertëve të huaj, jo vetëm ka rritur cilësinë e vlerësimeve por njëkohësisht ka bërë proceset më të besueshme.

APAAL, vendos në dispozicion të dy anëtarëve të KA, versionet anglisht të raporteve të vlerësimit për të tre ciklet e studimit si dhe për vlerësimin institucional në kuadrin e akreditimit. Ndërkohë, mjaft dokumente të APAAL, standartet shtetërore të cilësisë, ligji i arsimit të lartë, procedura etj, janë përkthyer nga APAAL në gjuhën angleze. Gjithashtu, është mundësuar përkthimi i përmbledhjeve të vlerësimeve të ekspertëve të programeve të studimit të aplikuara për licensim nga IAL publike/private (45 përmbledhje raportesh), përkthimi i analizës SËOT, të vlerësimeve të ekspertëve, të vlerësimit të jashtëm, në funksion të antarëve të huaj të Këshillit të Akreditimit (10 analiza SËOT), përkthimi i pjesëve të veçanta raportesh dhe dokumentesh të IAL etj

APAAL ka informuar institucionet për mënyrën e hartimit të raportit të vlerësimit të brendshëm në dy gjuhë. Gjithashtu, IAL janë informuar të përgatitin edhe mjaft dokumente të tjera, si statut, rregullore, programe etj, në gjuhën angleze, në mënyrë që të jenë në funksion të vlerësimit me ekspertë të huaj ose KA. Informacione të detajuara për KA dhe ekspertët e vlerësimit, APAAL ka publikuar në faqet e saj të internetit dhe broshurat e botuara.

9. Aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare në arsimin e lartë

- *Aktivitete në arsimin elartë*
- *Aktivitete ndërkombëtare*
- *Rekomandime*

Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, ka kontakte të drejtpërdrejta dhe të vazhdueshme me Ministrinë e Arsimit, Institucionet e Arsimit të Lartë në vend (IAL) dhe me aktorë të tjerë, të interesuar në këtë drejtim.

Disa nga këto aktivitete në të cilat APAAL ka marrë pjesë përmendim:

- Pjesëmarrjen në *“Platformën e monitorimit të Institucioneve të arsimit të lartë privat”*, me qasje: *“Vlerësimi i cilësisë së shërbimit arsimor dhe administrativ të Institucioneve të arsimit të lartë privat për realizimin e standardeve dhe detyrimeve që ato kanë në bazë të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore të dala për zbatim të tij”*. Në këtë pothuajse i gjithë stafi i APAAL ka qënë i angazhuar në grupet e punës të ngritura nga MAS. Në përfundim të proceseve, janë hartuar raportet individuale për çdo IAL si dhe është dhënë kontribut në hartimin e raportit përfundimtar të procesit.
- Pjesëmarrjen në në grupet e punës për realizimin e maturës shtetërore ku i gjithë stafi i APAAL ka qënë i angazhuar si vëzhgues në shkolla të ndryshme të vendit
- Pjesëmarrjen

Bashkëpunimi me IAL në vend ka qënë i vazhdueshëm. Asistenca teknike ndaj institucione përveç kontakteve të vazhdueshme, është fokusuar në informimin për çdo dokumentacion apo ndryshime të reja të APAAL, trajnime të ndryshme të kryera për njësitë e vlerësimit të brendshëm në IAL, trajnime për hartimin raporteve të vlerësimit të brendshëm në përputhje me standardet e reja të cilësisë.

APAAL është anëtare me të drejta të plota në, EENQA, INQAHE, EAIE, dhe prej vitit 2010 është anëtar i asociuar i ENQA (Organizata Europiane për Sigurimin e Cilësisë). Agjencia ka qënë pjesë e të gjitha aktiviteteve të organizuara nga këto rrjete dhe veçanërisht në aktivitetet e ENQA-s

Stafi i agjencisë është angazhuar në mjaft aktivitete ndërkombëtare të zhvilluara gjatë 2012 ndër të cilat veçojmë:

- Pjesëmarrjen në Simpoziumin e 5-të vjetor *“Për renditjen e universiteteve dhe sigurimin e cilësisë në Europë, 2012”* të organizuar

nga Qendra e Studimeve Parlamentare në bashkëpunim me Komisionin European dhe CHE, në Bruksel, Belgjikë

- Pjesmarrjen në datat 16-17 maj 2013, në Varshave Poloni, në Forumin e 6-të të IREG Oservatory për metodologjite e renditjes së universiteteve. Në këtë aktivitet APAAL ka prezantuar eksperiencen shqiptare të renditjes së universiteteve, problematikat dhe përmiresimet e modelit të zbatuar në vitin 2011 nga CHE- APAAL. Punimi i prezantuar në këtë aktivitet ka qënë "*Improving the ranking model of the Albanian higher education institutions*".
- Konferenca mbi Sigurimi dhe Zhvillimi i Cilësisë në Europë. Kjo Konferencë u organizua nga DAAD, Agjencia Kombëtare për bashkëpunim në arsimin e lartë në Europë dhe u mbajt në Berlin, Gjermani më 21 & 22 mars 2013.
- Forumi i tretë i antarëve të ENQA i mbajtur më 25 – 26 prill 2013 në Pragë, Republika Çeke. Ky forum u organizua nga ENQA në bashkëpunim me Komisionin e Akreditimit të Çekisë, ACCR. Pjesë e forumit ishte dhe Asambleja e Përgjithshme në të cilën u diskutuan dhe u miratuan:
 - Protokoli i mbledhjes së mëparshme të Asamblesë së Përgjithshme
 - Lista e kandidatëve të bordit të ENQA
 - Raporti i Auditit
 - Raporti financiar gusht 2011-dhjetor 2012
-
-
-

Gjatë gjithë këtyre aktiviteteve, APAAL ka prezantuar, paraqitur dhe informuar bashkëpunorët e saj për aktivitetet që kryen dhe synimet e saj në të ardhmen. Përfundimet e nxjerra nga këto aktivitete kanë qënë objekt diskutimi në APAAL dhe janë reflektuar në aktivitetin e agjencisë.

Anëtarësimi në ENQA (European Association for Quality Assurance in Higher Education) dhe në Regjistrin European të Agjencive (EQAR ka qënë në fokusin e APAAL për vitin 2013.

